ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **KUVENDI KOMUNAL MITROVICË**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **642-26-5924-5-1-1**

Sa i përket tenderit për **Ndërtimi i çerdhes për fëmijë në Vaganicë (Faza Përgaditore) dhe Ndërtimi i çerdhës për fëmijë në fshatin Kçiq i Madh**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj	**HARST Group SH.P.K.**
NUI	**810025090**
Adresa	**Harstgroup**
Vendi	**Suharekë**
Kodi postar	**23000**
Numri Telefonit	
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj	**Sadik Ramadani**
Adresa elektronike	**info@harstgroup.eu**
Data e parashtrimit të ankesës	**16.11.2026**

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

Emri i avokatit

Adresa e plotë

Numri i Telefonit

Numri i faks-it

Adresa elektronike

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës" "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit", apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Ankesa i përket grupeve:

Ndërtimi i çerdhes për fëmijë në Vaganicë (Faza Përgaditore) dhe Ndërtimi i çerdhës për fëmijë në fshatin Kçiq i Madh

Njoftimi per kontrate 21.07.2026

Proceverbali i hapjes 31.08.2026

Njoftimi per vendim -ANULIMI 29.10.2026

Kerkesa per rishqyrtim 03.11.2026

Vendimi - Pergjigje për kërkesës për rishqyrtim 06.11.2026

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ **Jo** ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☐ ***Jo*** ☒

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒ **Jo** ☐

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontestit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se.

Bashkangjitur Vendimin e AK ndaj kerkeses per rishqyrtim

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit,

dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1 i LPP-së- Qëllimi

Neni 6 i LPP-së- Ekonomiciteti dhe efikasiteti

Neni 7 i LPP-së – Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi

Neni 9.1 i LPP-së – Vlerësimi paraprak i nevojave, vlerës dhe kushteve të kontratës.

Neni 9.2 i LPP-së – Sigurimi i mjeteve financiare për detyrimet e vitit aktual fiskal.

Neni 9.3 i LPP-së – Baza financiare për detyrimet në vitet e ardhshme fiskale.

Neni 9.5 i LPP-së – Përgatitja dhe nënshkrimi i deklaratës së nevojave dhe

Neni 43-Ndërprerja e procedurave të prokurimit 43.1

Neni 59 i LPP-së – Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve

Neni 60 i LPP-së – Kriteret për Dhënien e Kontratës

Neni 62.2.1 i LPP-së – Kushtet për anulimin për shkak të tejkalimit të buxhetit për aktivitetin e prokurimit.

Neni 72 i LPP-së – Dokumentacioni dhe informacioni shtesë

Neni 8 -Përcaktimi i nevojave dhe disponueshmërisë së fondeve

8.1 Përcaktimi i nevojave dhe disponueshmërisë së fondeve nga ana e Autoriteteve kontraktuese

bëhet në pajtueshmëri me Nenit 9 të LPP-së. Nëse AK është autoritet publik ose organizatë

buxhetore ZKF do të siguroj që:

a. Fondet janë alokuar; ose

b. Fonde të mjaftueshme do të alokohen në vitin fiskal në fjalë. Kjo dispozitë do të

përfshihet në kontratën publike. "Alokimi"do të thotë këtu "shuma është

autorizuar", në mënyrë që të jetë në përputhje me buxhetin dhe sistemin e

pagesave. Qëllimi i sigurimit të fondeve të alokuar është që të përmirësohet

efikasiteti, pasi që inicimi i një procedure të prokurimit për të cilën nuk ka fonde

të alokuar thjesht mund të jetë humbje e resurseve.

8.2 Në pajtueshmëri me Nenin 9, paragrafi 5, të LPP-së Autoritetet Kontraktuese do të përdorë

formularin standard B04 "Deklarata e nevojave dhe përcaktimi i disponueshmërisë së fondeve

(DNPDF)" të përgatitur dhe miratuar nga KRPP për vlerësimin e nevojave dhe konstatimin e

disponueshmërisë e fondeve. Aprovimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit do të konfirmohet

me nënshkrim të DNPDF nga ZKA dhe ZKF.

8.3 DNPDF do të jetë pjesë e rexhistrit të dokumentacioneve të aktivitetit të prokurimit.

8.4 Gjatë përgatitjes së DNPDF, AK duhet të plotësoj në mënyrë të saktë dhe qartë të gjitha pjesët

e deklaratës.

8.5 Personat përgjegjës për nënshkrimin e kontratës dhe DNPDF janë të obliguar që para

publikimit të Formularit B58 "Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues", të

rikonfirmojnë që informatat financiare (DNPDF) nuk kanë ndryshuar.

8.6 AQP të identifikoj çdo artikull të përdorimit të zakonshëm

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë e rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

ANEX-ANKESA

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

Ne konsiderojme qe AK na ka bërë dëme materiale për përgatitjen dhe dorëzimin e ofertës, për kërkesën për rishqyrtim, si dhe damtime tjera në fitimin e pritur, vlerë të referencave, imazh dhe dëmtime tjera që mund të ndodhin në vlerë prej 925,713.92 Euro

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) *një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
b) *një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".*
c) *një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
d) *një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*
e) *bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,*
f) *Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe*
g) *të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*